



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2022:152258  
Datë: 15.05.2024  
Numri i dokumentit: 05685744

**A.nr.1871/2022**

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ të paditësve, S.M. dhe M.H. i nga komuna e ... të cilin me autorizim e përfaqëson ... avokate në ..., kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në mungesë të palëve ndërgjyqës, me datë 24.04.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve, .... dhe .... nga komuna e ..., me të cilën kanë kërkuar që të anulohen vendimi me nr. A.nr.522/2022 i datës 26.06.2022 me numër të protokollit 3706/20222 dhe vendimi me nr. A.nr.534/2022 i datës 14.07.2022, i protokolluar me numër 4131/2022 i të paditurit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

II. Shpenzimet procedurale i bartë secila palë veta në procedurë.

**A r s y e t i m**

Me datën 24.04.2024 është mbajtur shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridiko-administrative, në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në mungesë të palëve ndërgjyqëse të ftuara në mënyrë të rregullt gjyqësore.

Paditësit përmes të autorizuarës së tyre me padinë e parashtruar në gjykatë me datën 27.07.2022, kanë kërkuar nga gjykata që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e tyre si e bazuar dhe të anulohen vendimet

me numër A.nr.522/2022 i datës 26.06.2022 me numër të protokollit 3706/20222 dhe vendimi me numër A.nr.534/2022 i datës 14.07.2022, i protokolluar me numër 4131/2022 i të paditurit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës dhe të detyrohet Universiteti i Prishtinës që të bëjë kompensimin e përqindjes se inflacionit në bazë të pagës bruto, që nga data 18.04.2017, e gjerë shkaktimit të demit (për secilin kërkesë veç e veç, ashtu që siç parashihet në piken XVII të mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të datës 01.12.2020 e gjer në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës, e të gjitha në aftat prej 7 ditsh nga plotfuqishmërisë të aktgjyqimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

E paditura me përgjigje në padi të parashtruar në këtë gjykatë me datën 03.01.2024, e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke propozuar që gjykata të merr aktgjykim me të cilin padinë e paditësit e refuzon si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi me numër A.nr.522/2022 i datës 26.06.2022 me numër të protokollit 3706/20222 dhe vendimi me nr. A.nr.534/2022 i datës 14.07.2022, i protokolluar me numër 4131/2022 i të paditurit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datë 24.04.2024 ka administruar provat relevante dhe atë: vendimi me numër A.nr.522/2022 i datës 24.06.2022; ankesa për kompensimin e përqindjes se inflacionit e datës 13.06.2022; kërkesa për kompensimin e përqindjes se inflacionit e dt.06.05.2022; njoftimi lidhur me kërkesën i lëshuar nga Këshilli Drejtues i UP-se i dt.23.05.2022 me numër 1/133; Akt emërimi me numër Ref.1/39 i dt.24.04.2012 për ...; ankesa për kompensimin e përqindjes se inflacionit e dt.15.06.2022; vendimi i datës 14.07.2022 me numër A.nr.534/2022; Akt Emërimi me numër Ref.1/38 i dt.24.04.2012 për ...; vendimi i datës 29.03.2019 me numër 03/4 për ...; lista e pagave për ...; formulari i regjistrimit te ankesës për .... e dt.15.06.2022; fletë- kthesa e dt.15.07.2022, e pranuar nga AV. ... me dt.18.07.2022; fletë-kthesa e dt.15.07.2022 dorëzuar postes me 19.07.2022; formulari i regjistrimit te ankesës për ... e dt.13.06.2022; fletë-kthesa e .... e dt.24.06.2022 dhe fletë-kthesa për ... e dt.05.07.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditësve është **e pa bazuar.**

Gjykata nga shkresat e lëndës ka vërejtur se paditësit kanë kërkuar kompensimin në pagën mujore të shkallës se inflacionit nga data 18.04.2017 deri ne pagesën definitive, në vështrim te nenit 35 paragrafi

10 i Kontrate Kolektive të Arsimit të Republikës së Kosovës, e që për paditësin e parë ..., shihet se, e paditura me vendimin me numër A.nr.534/2022 të datës 14.07.2022, është shpallur jo kompetent për

të vendosur lidhur me ankesën e datës 15.06.2022, të parashtruar nga ankuesi ..., po ashtu edhe për paditësin e dytë ...sa, shihet se e paditura me vendimin me numër A.nr.522/2022 të datës 24.06.2022, është shpallur jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e datës 3.06.2022 të parashtruar nga ankuesi ....

Paditësit të pakënaqur me vendimet kontestuese, kanë ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 27.07.2022, duke e kontestuar ligjshmërinë e tyre.

Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi iu referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se, Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. 4. Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike; 5. Nëpunës i Kabinetit - është zyrtari publik, që ushtron detyrën në Kabinetin e Presidentit, të Kryetarit të Kuvendit, të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit, të Ministrit ose të titullarit të një institucioni të pavarur kushtetues dhe të Kryetarit të Komunës. Statusin e nëpunësit të Kabinetit e kanë edhe nëpunësit të cilët ushtrojnë detyrat për nën kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe për grupin parlamentar. 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.

Gjykata në interpretim të dispozitës së lartcekur ka vlerësuar se, Zyrtaret Publikë të Nivelit të Lart Drejtues, Profesional dhe Shërbimeve të Brendshme në kuadër të Institucioneve Publike të Arsimit të lartë të Kosovës, kanë statusin e nëpunësit të shërbimeve publike, respektivisht të njëjtit nuk janë nëpunës civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen-paragrafi 1.1 i Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesa e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranimin në shërbimin civil, andaj Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e Nëpunësve Civil dhe Shërbimit Civil të Kosovës, e që në rastin konkret nuk ka kompetencë për të vendosur lidhur me ankesën të parashtruar nga ankuesit këtu paditësit.

Ndërsa sa i përket, ankesës së ankuesit këtu paditësve, kolegji pran të paditurës kanë vendosur në mënyrë të drejt kur e kanë shpall veten jo kompetent, sepse duke i'u referuar shkresave të lëndës shihet se paditësi, ..., mbanë pozitën e punës "zytar i shebimeve te studenteve", në universitetin e Prishtinës e cila pozitë nuk është pozitë e nëpunësit civil siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 2 paragrafit 6 ku përcaktohet se: Nëpunës Administrativo-teknik dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtës, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike. Ndërsa paditësi ... në pozitën "Sekretar", cila pozitë nuk është pozitë e nëpunësit civil siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 2 paragrafit 4 ku përcaktohet se: zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësve dhe gjeti se, të njëjtat në këtë çështje administrative, nuk kanë ndikim në vendosje tjetër, nga ajo që ka vendosur organi i paditur. Nga kjo, gjykata vlerëson se vendimet kontestuese janë të drejta dhe të bazuara në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka shpall jo kompetent lidhur me ankesat e paditësve. Mbi këto arsye kërkesëpadinë e paditësve nuk e aprovoi, sepse sipas vlerësimit të gjykatës, nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit.

Gjykata me rastin e vendosjes për këtë çështje, po ashtu, e pa të udhës të udhëzoj palën që për realizimin e të drejtës nga marrëdhënia e punës lidhur me kontratave kolektive të drejtohet në procedurë civile duke pasur parasysh mendimin juridik të Gjykatës Supreme Nr. 40/2023 të datës 27.02.2023, i cili mendim në pikën I të dispozitivit të të cilit është përcaktuar se "Për marrëdhëniet e punës që kanë lindur pas datës 15.12.2010, zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës-Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, viti V/nr.9, datë 01.12.2010".

Mbi bazën e asaj që u argumentua më lartë gjykata gjeti se kërkesëpadija e paditësve është e pa bazuar dhe vlerëson se nuk është cenuar ligji në dëm të tyre andaj të njëjtën e refuzoi duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në kuptim të nenit 64 te LKA.

Duke u bazuar në të dhënat e lartë cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.parg.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Administrative**  
**A.nr. 1871/2022 datë 24.04.2024**

G j y q t a r e  
Luljeta Maxhuni

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,  
në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit,  
në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.